

PARTNERITETET PUBLIKE-PRIVATE



ZVOGËLIMI I HENDEKUT INFRASTRUKTUROR NË KOSOVË

Në ekonominë e sotme globale, infrastruktura dhe shërbimet moderne dhe efikase janë një parakusht i domosdoshëm për rritje të suksesshme dhe të qëndrueshme ekonomike.

“Hendeku infrastrukturor”, i definuar si dallimi në mes të resurseve në dispozicion dhe shumës së investimeve të domosdoshme për të plotësuar nevojat thelbësore infrastrukturore të vendit, ka ndikim negativ në rritjen ekonomike dhe në krijimin e vendeve të punës.

Kosova ka nevojë urgjente për të zgjeruar dhe për të rritur efikasitetin e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Por, qeveria ka resurse të kufizuara financiare për t’i ndarë ato për shpenzime kapitale dhe për shërbime të zgjeruara publike. Si rezultat, hendeku infrastrukturor i Kosovës, i vlerësuar të jetë mbi një miliardë euro, është i madhe dhe është duke u rritur.

Në mënyrë që të zvogëlohet hendeku në mes të resurseve publike në dispozicion dhe kostoja e infrastrukturës dhe shërbimeve që nevojiten, si dhe të sigurohet se infrastruktura dhe shërbimet të ofrohen në mënyrë sa më efikase dhe me kosto sa më të volitshme që të jetë e mundur, autoritetet publike po kthehen kah Partneritetet-Publike-Private.

Përmes infuzionit të kapitalit dhe të menaxhimit privat, Partneritetet-Publike-Private (PPP) mund të lehtësojnë kufizimet fiskale dhe të rrisin efikasitetin në ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Sidoqoftë, përkundër potencialit të tyre, Partneritetet-Publike-Private janë instrumente shumë komplekse të politikave.

Do të thotë, PPP-të kanë demonstruar përfitimin, duke sjellë përmirësime në infrastrukturë dhe në shërbimet publike brenda një kohe të shkurtër, vlerë më të mirë për para dhe inovacion të shtuar nëpër shumë sektorë. Por, kjo nuk do të thotë se implementimi i programit ose projektit të PPP-së është i lehtë. Në fakt, për ofrimin e shërbimeve publike drejt modelit në të cilin sektorët publikë dhe privatë punojnë së bashku, duhet të tejkalohen pengesa të rëndësishme politike, ligjore dhe rregullative në mënyrë që të largohemi nga modeli tradicional i sektorit publik.

PPP-ja i ofron Kosovës mundësinë për të modernizuar dhe për të zgjeruar infrastrukturën dhe shërbimet e saja publike. Me ligjin e ri mbi Partneritetet-Publike-Private dhe me themelimin e një njësie qendrore të PPP-së në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, korniza institucionale dhe ligjore është vendosur në mënyrë që të lejohen ministritë, NP-të, komunat dhe organizatat e tjera buxhetore që të fillojnë me implementimin e PPP-së përgjatë shumë sektorëve.

HENDEKU INFRASTRUKTUROR NË RRIJTJE

Hendeku infrastrukturor – shumica e investimeve që duhen për të plotësuar nevojat kryesore infrastrukturore – është i madhe dhe duke u rritur. Mesatarisht, vendet në zhvillimit duhet të shpenzojnë 5% të BPV në shpenzimet kapitale në infrastrukturë, në mënyrë që të mbulohet zbrazësia. Kosova, si një vend i ri, duhet të investojë edhe më shumë.

PARATHËNIE PËR PPP

ÇFARË JANË PARTNERITETET-PUBLIKE-PRIVATE?

Nuk ekziston vetëm një përkufizim i pranuar nga të gjitha përkufizimet ndryshme për Partneritetet-Publike-Private. Fatkeqësisht, PPP-ja shpesh ka kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm, gjë që mund ta bëjë të vështirë ndonjëherë vlerësimin dhe krahasimin me përvojat ndërkombëtare.

Sidoqoftë, Partneritetet-Publike-Private, në përgjithësi, u referohen formave të bashkëpunimit në mes të autoriteteve publike dhe sektorit privat e që kanë për qëllim të sigurojnë financimin, ndërtimin, renovimin, menaxhimin, operimin dhe/ose mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe/ose ofrimin e shërbimeve.

Në thelb, të gjitha Partneritetet-Publike-Private përfshijnë një formë të ndarjes së rrezikut në mes të sektorit publik dhe sektorit privat, në ofrimin e infrastrukturës ose shërbimit. Ndarja e rrezikut për partnerin privat është përcaktuesi kryesor në dallimin në mes të PPP-së dhe modelit tradicional të sektorit publik të ofrimit të shërbimeve publike.

Ekzistojnë dy forma themelore të Partneriteteve-Publike-Private: PPP-të kontraktuale dhe PPP-të institucionale. Edhe pse PPP-të institucionale kanë qenë mjaft të suksesshme në disa rrethana, posaçërisht në vende me kapacitete të zhvilluara institucionale dhe rregullative, PPP-të kontraktuale janë metodologji shumë më e zakonshme, posaçërisht në ekonomitë në zhvillim.

Përkundër faktit se nuk ka konsensus universal për definicionin e partneriteteve-publike-private, elementet në vijim kryesisht karakterizojnë PPP-të:

- PPP-të në mënyrë tipike janë marrëveshje kontraktuale ose institucionale në mes të sektorit publik dhe palës nga sektori privat për ofrimin privat të infrastrukturës dhe shërbimeve publike ose shërbime tjera themelore.
- Infrastruktura ose shërbimi financohet, plotësisht ose pjesërisht, nga partneri privat.
- Rreziqet ndahen në mes të partnerit publik dhe të partnerit privat, duke bërë ndarjen të pala e cila është më së miri e pozicionuar për ta menaxhuar secilin rrezik individual.
- PPP-të janë struktura komplekse, në të cilat përfshihen palë të shumfishta dhe kostoja relativisht e madhe e transaksionit.
- Partneritetet-Publike-Private janë vegël e prokurimit, në të cilën në fokus është pagesa për ofrimin e suksesshëm të shërbimeve (transferi i rrezikut të performancës të partnerit privat).
- PPP-të janë marrëveshje të bazuara në output / performancë (modeli tradicional i ofrimit të shërbimeve publike është "i bazuar në input").
- PPP-të zakonisht përfshijnë shërbimet 'grumbull' (p.sh., dizajni, ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi) në mënyrë që të maksimizohet sinergia dhe të mos inkurajohen propozimet me kapital të vogël/kosto të madhe të operimit.


Në përgjithësi, PPP-të ofrojnë një qasje të re dhe dinamike për menaxhimin e rrezikut në ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve.

PRIZMI I OPSIONEVE PËR PPP-TË

Siç u përmend më herët, ka shumë definicione përreth botës për PPP-të, por në përgjithësi, partneritetet-publike-private bien në mes të modelit tradicional të sektorit publik për ofrimin e shërbimeve publike dhe privatizimit të plotë. Brenda këtij prizmi, sidoqoftë, ekziston një numër i pafund i strukturave potenciale të transaksionit të PPP-së, të cilat mund të përdoret, varësisht nga qëllimet dhe nevojat e sektorit publik.

Vendimi për dizajnin specifik të transaksionit do të varet nga ajo se cilat rreziqe dhe përgjegjësi do të mbesin tek autoritetet publike dhe cilat do të transferohen tek partneri privat.

SPEKTRI I OPSIONEVE TË PPP



Me lëvizjen nëpër spektrin e opsioneve të kontraktimit, nga kontratat tradicionale të punëve dhe shërbimeve publike drejt shitjes dhe privatizimit, rreziqet dhe përgjegjësitë e sektorit privat rriten.

Për shembull, me kontratat e menaxhimit, autoritetet publike mbajnë pronësinë dhe përgjegjësitë e investimeve, por transferojnë menaxhimin dhe operacionet te partneri privat. Më tutje gjatë spektrit, me koncesion, skemat e Ndërtimit-Operimit-Transferimit (përfshi BTO, BOOT, DBFO, PFI, etj.), dhe marrëveshjet për qirradhënie afatgjatë, por transferojnë përgjegjësitë e investimit dhe operacioneve/ menaxhimit te partneri privat. Me BOO dhe shitje, pronësia, operacionet dhe përgjegjësitë investimeve, të gjitha, transferohen te partneri privat, përderisa sektori publik mbanë vetëm përgjegjësinë për rregullim dhe planifikim strategjik të sektorit.

Me fjalë të tjera, modalitetet e ndryshme të kontratave të PPP-ve reflektojnë ndarjen e veçantë të rrishtit dhe përgjegjësi.

PPP FJALORTH SHKURT

Në botën e Partneriteteve-Publike-Private, akronimet ndodhen gjithandej. Disa prej akronimeve dhe modeleve më të shpeshta të PPP janë përshkruar më poshtë:

KONTRATA E SHËRBIMIT:

Qeveria kontraktton një entitet privat për të ofruar shërbime të cilat i kishte ofruar qeveria më herët.

KONTRATA E MENAXHIMIT (MC):

Qeveria kontraktton një entitet privat për të operuar dhe menaxhuar një hapësirë (shërbime të shumëfishta).

QIRA: Qeveria lëshon me qira aset in për operatorët privatë për një shumë të caktuar. Operatori privat merr përsipër rrezikun operacional. Në disa raste, marrëveshja e qirasë mund të përfshijë kërkesat e investimeve (p.sh., strukturat e kontratës Qira-Zhvillim-Operim).

KONCESION: Qeveria ose autoriteti publik i siguron entitetit privat të drejtat ekskluzive për të ofruar, operuar, dhe mirëmbajtur ndonjë aset të infrastrukturës për një kohë të caktuar kohore. Partneri privat merr përsipër rrezik të konsiderueshëm për investim, përderisa sektori publik mban pronësinë e asetit origjinal. Shembujt përfshijnë:

- **Rehabilitimi, operimi, dhe transferimi (ROT):** Një sponsor privat rehabiliton një hapësirë ekzistuese, pastaj operon dhe mirëmban hapësirën në rrezik të vetin për periudhën e kontratës.
- **Rehabilitimi, qiradhënia, dhe transferimi (RLT):** Një sponsor privat rehabiliton ndonjë hapësirë ekzistuese me rrezik të vetin, merr me qira hapësirën nga pronari qeveritar, pastaj operon dhe mirëmban hapësirën me rrezik të vetin për periudhën e kontratës.
- **Ndërtimi, rehabilitimi, operimi, dhe transferimi (BROT):** Zhvilluesi privat ndërton një shtojcë në hapësirën ekzistuese ose kompletton një hapësirë gjysmë të ndërtuar dhe rehabiliton asetet ekzistuese, pastaj operon dhe mirëmban hapësirën me rrezik të vetin për periudhën e kontratës.

PROJEKTET E GREENFIELD:


Entiteti privat ose kapitali i përbashkët publik-privat ndërton dhe operon një hapësirë të re për periudhën e specifikuar në kontratën e projektit. Hapësira mund të kthehet ose jo në sektorin publik në fund të periudhës së koncesionit. Projektet greenfield mund të organizohen nëpër kategori:

- **Ndërtimi, qiradhënia, dhe transferimi (BLT):** Sponsor i privat ndërton një hapësirë të re në rrezik të vetin, transferon pronësinë të qeveria, merr me qira hapësirën nga qeveria dhe operon në rrezik të vetin deri sa të skadon qiradhënia.
- **Ndërtimi, operimi, dhe transferimi (BOT):** Sponsor i privat ndërton një hapësirë të re në rrezik të vetin, operon me hapësirën në rrezik të vetin, dhe pastaj transferon hapësirën të qeveria në fund të periudhës së kontratës. Sponsor i privat mund të ketë ose jo pronësinë e aseteve gjatë periudhës së kontratës. Kjo gjithashtu shpesh njihet edhe si DBFO (Dizajnimi-Ndërtimi-Financimi-Operimi).
- **Ndërtimi, pronësia, dhe operimi (BOO):** Sponsor i privat ndërton një hapësirë të re në rrezik të vetin, pastaj e ka në pronësi dhe operon me hapësirën në rrezik të vetin.
- **Dizajnimi-ndërtimi-financimi-operimi (DBFO):** Entiteti privat financon dhe ndërton asetet, gjë që i jep shtytje entitetit privat që të përfundojë me kohë dhe brenda buxhetit. Aseti paguhet nga sektori publik vetëm kur të jetë kompletuar. Kjo është e zakonshme nën modelin PFI (Iniciativë e financimit privat).

SHITJA: Qeveria transferon një aset, qoftë pjesërisht ose plotësisht, në sektorin privat. Zakonisht qeveria do të përfshijë disa kushte të caktuara së bashku me shitjen e asetit për të siguruar se do të bëhen përmirësime dhe shërbimi do të vazhdojë të ofrohet.

LAKORJA E SHPËRBLIMIT-RREZIKUT TË PPP-VE DHE MODELET E KOMPENSIMIT

Duke ditur se partneritetet-publike-private ndajnë rreziqe të caktuara për partnerin privat, entiteti privat duhet të kompensohet për marrjen përsipër të këtyre rreziqeve. Në përgjithësi, sa më i madh të jetë rreziku, aq më i madh është kthimi i kërkuar.



RAPORTI RREZIK-SHPËRBLIM SIPAS MODALITETIT TË KONTRATËS

Në marrëveshjet e PPP-ve, partneri privat zakonisht kompensohet përmes:

- Pagesave të bëra nga shfrytëzuesit (p.sh. taksa rrugore, tarifet e aeroporteve, etj.);
- Pagesave të disponueshmërisë nga autoritetet publike (p.sh. PFI, PPA, WPA, etj.); ose
- Kombinimin e këtyre dy formave të përmendura më lart.

Zakonisht në rast të strukturave të bazuara në pagesat e shfrytëzuesve, qeveria ose autoriteti publik do të ketë nevojë të ofrojë ndonjë lloj të përkrahjes financiare për projektin, në mënyrë që të zbusë rreziqe të caktuara, si për shembull rrezikun e kërkesës, ose të sigurojë se rikthimi i kostos së plotë është i përshtatshëm me kriteret e mundësisë dhe aftësisë së publikut për të paguar. Mekanizmat e përkrahjes nga qeveria mund të marrin forma të ndryshme, si për shembull kontributet, investimet, garancitë dhe subvencionet, por duhet të dizajnohen me kujdes dhe të implementohen, në mënyrë që të sigurohet një ndarje optimale të rrezikut në mes të sektorëve publik dhe privat. Kur përkrahja nga qeveria është e pranishme, qëllimi është që të maksimizohet mobilizimi i kapitalit privat për njësi të kontributit të sektorit privat.

Në PPP-të e infrastrukturës, ofruesit e shërbimeve paguhet për të ofruar një nivel të caktuar të shërbimit (jo inputeve). Me fjalë tjera, pagesat janë të mundshme pasi që ofruesi privat i shërbimeve të ofrojë shërbimin sipas standardit të pajtuar të performancës. Në fakt esenca e PPP-ve është, "Nuk ka ofrim të shërbimit, atëherë nuk ka as pagesë".

Pagesat e disponueshmërisë qëndrojnë në qendër të njëres prej formave të PPP-ve, modeli i Iniciativës të Financimit Privat (PFI). PFI-ja është sistem për ofrimin e aseteve kapitale për dorëzimin e shërbimeve publike. I lindur në M.B., ky model përdoret për një numër të madh të projekteve infrastrukturore dhe i ofron sektorit privat shtytje të fuqishme për të ofruar infrastrukturë dhe shërbime me kohë dhe brenda buxhetit dhe në të njëjtën kohë lejon qeveritë dhe autoritetet publike që të shpërndajnë koston e këtyre projekteve të infrastrukturës publike përgjatë një periudhe të gjatë (20-30 vjet).

Kjo krijon siguri më të madhe buxhetore, e gjithashtu liron resurset e pakta publike për prioritetet tjera shoqërore.

MEKANIZMAT E PËRKRAHJES NGA QEVERIA:

Autoritetet kontraktuese mund të ofrojnë përkrahje financiare ose të zvogëlojnë rrezikun financiar për projekte në shumë mënyra. Disa forma të zakonshme të përkrahjes qeveritare përfshijnë këto në vijim:

- Subvencionimi me para të gatshme – Qeveria ose autoriteti publik pajtohet që të subvencionojë projektin me para të gatshme. Mund të jetë një shumë paushall ose fikse në baza njësie dhe pagesa mund të bëhet qoftë me këste, qoftë e tëra përmjetherë.
- Garancion i pagesës – Qeveria pajtohet që të përmbushë obligimet e blerësit (zakonisht ndërmarrje publike) në raport me entitetin privat, në rast se nuk ka performancë nga blerësi. Shembulli më i shpeshtë i kësaj është kur qeveria garanton pagesën fikse të marrëveshjes off-take (p.sh. Marrëveshja e Blerjes së Energjisë (MBE), Marrëveshja e Blerjes së Ujit (MEU)) në mes të entitetit privat dhe ndërmarrjes publike.
- Garancioni borxhit – Qeveria siguron huamarrjet e entitetit privat. Do të thotë, qeveria garanton kthimin e huas te kreditorët, në rast të mosplotësimi nga entiteti privat.
- Garancioni i të hyrave – Qeveria cakton një të ardhur variable minimale për partnerin privat; zakonisht kjo e hyrë vjen nga pagesat e shfrytëzuesve. Kjo formë e garancionit është më e zakonshme në rrugë trafik minimal ose të hyra të caktuara nga qeveria.

VLERA PËR PARA – PPP KUNDREJT INVESTIMEVE TË PASTRA PUBLIKE

Është e rëndësishme të vërehet se jo të gjitha projektet janë të përshtatshme për PPP. Partneritetet Publike-Private duhet të ofrojnë vlerë të barabartë ose më të mirë për paratë në krahasim me qasjen 100% të sektorit publik. Njësia e PPP-ve e kupton këtë dhe do të punojë me institucionet për të vlerësuar si duhet zbatueshmërinë e projekteve të PPP-ve vis-à-vis opsioneve tjera të financimit dhe implementimit. Qëllimi është që të përmirësohen shërbimet dhe të ofrohet “vlera më e mirë për para”.

Vlera për para është shtytësi kryesor në partneritetet publike private. Vlera për para nuk do të thotë thjeshtë përzgjedhja e ofertës më të lirë ose çmimit më të ulët të aseteve; por do të thotë që të gjendet zgjedhja më e mirë afatgjate për ofrimin e shërbimeve. Në të përfshihen analizimi i koston së përgjithshme afatgjate (kostoja e ciklit të jetës) të ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimi i përfitimeve shoqërore për publikun në përgjithësi.

Kur të krahasohet me qasjen e sektorit publik, përfitimet shtesë të PPP-ve mund të vijnë nga:

- Implementimi më i shpejtë i projekteve infrastrukturore;
- Shërbime dhe mbulim më i mirë;
- Fokusimi i ciklit të jetës të ofrimit të shërbimeve / kosto më e vogël e ciklit të jetës (afatgjatë);
- Efikasitet dhe inovacion i përmirësuar; dhe
- Ndarja e rrezikut e dizajnuar për të krijuar shtytje drejt suksesit.

PËRFITIMET DHE SFIDAT E PPP-VE

Është shumë pak e mundshme që partneritetet-publike-private do të zëvendësojnë plotësisht modelin tradicional të sektorit publik për ofrimin e shërbimeve publike. PPP-të janë vetëm një vegël, në mesin e shumë tjerave, që janë në dispozicion të qeverive dhe autoriteteve publike për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve.

Sidoqoftë, pasi që u tha kjo, PPP-të kanë treguar potencialin e vet në adresimin e mungesës së infrastrukturës dhe të arritjes të vlerave të mira për para. Disa përfitime të dukshme të PPP-ve përfshijnë:

- Implementim më i shpejtë i projekteve infrastrukturore: Për shkak të faktit se pagesa është e lidhur me ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve, PPP-të kanë një histori të besueshme të përfundimit të ndërtimeve me kohë ose edhe para afatit. Përveç kësaj, duke ditur se PPP-të në përgjithësi lejojnë publikun që të shpërndajë koston e investimeve në infrastrukturë përgjatë jetës së asetit, sektori publik mund të avancojë projektet infrastrukturore pa pasur nevojë për kapital të rëndësishëm paraprakisht. Kjo lejon që publiku të përfitojë shumë më shpejt nga investimi, sesa me financimin tradicional “paguaj gjatë ndërtimit”.
- Lëvizshmëria e buxhetit / kapitali shtesë: Duke zhvendosur përgjegjësitë financuese te pala private, partneritetet-publike-private rezultojnë me një infuzion të kapitalit privat në infrastrukturën dhe shërbimet publike. Ky mobilizim i kapitalit shtesë lejon qeveritë që të rrisin nivelin e përgjithshëm të investimeve në zhvillimin e infrastrukturës.
- Ndarja optimale e rrezikut: PPP-të zhvendosin rreziqet specifike të ciklit të jetës te partneri privat, dhe me këtë krijojnë shtytje për ofrimin më të mirë dhe me kosto efektive të shërbimeve. Për shembull, duke zhvendosur rrezikun e ndërtimit, operimit, dhe mirëmbajtjes te partneri privat, krijohet shtytje e fuqishme për të ofruar një hapësirë me kualitet të lartë, e cila është e përshtatura për operime dhe nuk prishet lehtë. Gjithashtu, duke lidhur pagesat me disponueshmërinë infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve, partneri privat është i motivuar ekonomikisht që të ofrojë infrastrukturën me kohë dhe të ofrojë shërbime me kualitet të lartë.
- Orientimi drejt shërbimit të konsumatorëve: Duke parë shfrytëzimin e shtytjeve të bazuara në performancë, PPP-të kanë një histori të vërtetuar të përmirësimit të kualitetit dhe të nivelit të shërbimeve. Ofruesit e specializuar privatë të shërbimeve ofrojnë ekspertizë të avancuar, përderisa inovacioni i sektorit privat lehtëson ofrimin e shërbimeve kualitative. Për më tepër, me largimin e sektorit publik nga ofrimi i përditshëm i shërbimeve, qeveria është në gjendje që të veprojë si një rregullator më efektiv, duke u fokusuar në sigurimin se operatori privat ofron nivelet e kërkuara të shërbimeve nga konsumatori.
- Efikasiteti i shtuar dhe kursimi në kosto: Efikasiteti i sektorit privat, së bashku me ndarjen optimale të rrezikut, mund të krijojë kursime të rëndësishme në kosto gjatë ofrimit të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Kursimet në kosto nga PPP-të zakonisht materializohen në formë të kostos më të ulët të ndërtimit, koston më të ulët të ciklit të jetës, efikasitet të shtuar dhe koston më të ulët të rreziqeve të ndërlidhura.
- Gjenerimi i të hyrave shtesë: Inovacioni dhe motivi i fitimit të sektorit privat mund të krijojnë shtytje për partnerin privat që të zhvillojë burime të reja dhe kreative të të hyrave nga infrastruktura publike. Këto burime të reja të të hyrave mund të ndahen me publikun, duke krijuar burime shtesë të të hyrave për prioritetet tjera shoqërore.
- Zhvillimi i sektorit privat / mundësitë e investimit: Si gurthemel i çdo ekonomie moderne, sektori privat në mënyrë të vazhdueshme është në kërkim të mundësive të reja të investimit. PPP-të ofrojnë mundësi stabile, afatgjate për investim për sektorin privat, si dhe mundësinë për të hyrë në sektorët e shërbimeve që më parë ishin të monopolizuara nga autoritetet publike.
- PPP-të lejojnë sektorin publik të fokusohet në funksionet dhe rezultatet strategjike: Duke e liruuar sektorin publik nga ofrimi i drejtpërdrejt i shërbimeve jostrategjike, qeveritë mund të fokusojnë resurset e tyre të kufizuara në misionet e tyre thelbësor.

“PPP mbajnë premtimin e rritjes së furnizimit të infrastrukturës pa mbingarkuar financat publike të shtetit. Një infuzion i kapitalit dhe i menaxhimit privat mund të lehtësojë kufizimet fiskale dhe të rrisë efikasitetin ...” IMF, Financat dhe zhvillimi, dhjetor 2004

Sidoqoftë, përkundër potencialit të tyre, PPP-të nuk janë zgjidhje për të gjitha problemet. Partneritetet-Publike-Private kanë disa sfida unike, të cilat duhet ditur:

- PPP-të janë struktura komplekse dhe relativisht jofleskibile.
- Prokurimi dhe implementimi i PPP-ve mund të jetë i gjatë dhe i kushtueshëm, duke e bërë të papërshtatshme për disa projekte.
- PPP-të vendosin përgjegjësi shtesë mbi sektorin publik, i cili duhet të jetë i gatshëm që të veprojë si palë kompetente dhe rregullatore. Kjo mund të kërkojë një rregullim tjetër të aftësive të qeverisë, p.sh. menaxher me përvojë në negociime, menaxhimi i kontratës dhe analizat e rrezikut.
- PPP-të mund të shpijnë drejt tarifave më të mëdha për shfrytëzuesit, pasi të largohen subvencionet implicite ose eksplicite. Kjo nuk do të thotë se mund të jetë pasojë e drejtpërdrejt e PPP-ve, por publiku mund t'i shohë tarifatat dhe ngarkesat e rritura si pasojë e nevojës së partnerit privat për kthim në investim.
- PPP-të nuk arrijnë transfer absolut të rrezikut. Sektori publik do të mbajë një pjesë të rrezikut.
- Jo të gjitha projektet janë të përshtatshme për PPP-të.

Në të vërtetë, edhe pse PPP-të kanë përfitime të rëndësishme si vegël e ofrimit të infrastrukturës, kur bëhen ashtu si nuk duhet, PPP-të mund të gjenerojnë probleme të konsiderueshme. Për këtë arsye, qeveritë dhe autoritetet publike duhet të kërkojnë ndihmë të ekspertëve për t'u siguruar se programet dhe projektet e PPP-ve të arrijnë qëllimet e përcaktuara, duke maksimizuar vlerën për para.

TRENDET GLOBALE NË PPP-TË

Partneritetet-Publike-Private janë një segment në rritje të prokurimit publik në të gjithë botën. Gjatë dhjetë viteve të fundit, qeveritë dhe autoritetet publike çdo herë e më shumë po i kthehen PPP-ve si një vegël e ofrimit të infrastrukturës në shumë sektorë dhe ky trend nuk duket se do të ndalet.

Edhe pse përvoja me PPP-të mund të dallojë shumë nga shteti në shtet ose nga rajoni në rajon, tabela në vijim përmbledh disa mundësi kryesore të infrastrukturës për PPP-të që do të mund të ishin të përshtatshme për Kosovën:

SEKTORI	NËN-SEKTORI	MODELET INDIKATIVE TË PPP
TRANSPORT	<ul style="list-style-type: none"> ■ Aeroportet ■ Rrugët ■ Hekurudhat 	BOT, BTO, BOOT, PFI, Koncesion, MC, shitje, tjera.
ENERGJI	<ul style="list-style-type: none"> ■ Energjia elektrike ■ Gazi natyror 	BLT, BOOT, Koncesion, MC, shitje, tjera.
UJËSJELLËS DHE KANALIZIM	<ul style="list-style-type: none"> ■ Fabrikat e trajtimit ■ Komunalit 	BT, BLT, BOOT, Koncesion, MC, shitje, tjera.
ARSIM	<ul style="list-style-type: none"> ■ Infrastruktura e shkollës ■ Hapësirat e hulumtimeve ■ Hapësirat dhe shërbimet për universitete 	DBFO / DBFOM (PFI), MC
SHËNDETËSI	<ul style="list-style-type: none"> ■ Infrastruktura e spitaleve ■ Shërbimet klinike dhe jo-klinike ■ Koncesionet master të spitaleve 	DBFOM (PFI), MC, tjera.
PUNËT KOMUNALE RENOVIMI URBAN MIRËQENIE SOCIALE	<ul style="list-style-type: none"> ■ Ndërtesat publike ■ Strehimi publik ■ Ngrohja qendrore ■ Sporti dhe zbavitja ■ Parking / Transport ■ Tjera 	PFI, BTO, BOT, BOOT, BOO, tjera.
BURGJET	<ul style="list-style-type: none"> ■ Hapësirat korrektuese 	DB, DBOM, BTO, BOO, MC.
TJERA	<ul style="list-style-type: none"> ■ TI ■ Turizëm ■ Ambienti ■ Parqet industriale 	DB, DBFOM (PFI) BOO, MC, tjera.

CIKLI JETËSOR I PPP-VE

Gjatë implementimit të Partneriteteve-Publike-Private, është e rëndësishme që të adoptohet perspektiva e ciklit të jetës. Suksesi varet, në pjesë të madhe, nga kapaciteti i qeverisë që të ekzekutoj dhe të menaxhoj partneritete inovative.

Shpesh i kushtohet shumë vëmendje transaksionit, duke lënë anash faktorët tjerë kritikë. Sigurisht, transaksioni është një komponentë e rëndësishme e PPP-ve, por është vetëm një pjesë e vogël e një kornize më të gjerë. Me rëndësi të njëjtë janë edhe themelimi i kornizës ligjore, rregullative, institucionale dhe politike për PPP-të; sigurimi se akterët do të japin përkrahjen; menaxhimi i procesit të ndryshimit; aplikimi i modeleve të duhura të rrezikut; zhvillimi i strukturave të duhura të mbikëqyrjes dhe të monitorimit; dhe inkorporimi i PPP-ve në strategjitë e gjera të sektorit. Me fjalë tjera, në mënyrë që Partneritetet-Publike-Private të jetë i suksesshëm, ato duhet të implementohen brenda një kornize më të gjerë të politikës e cila merr parasysh të gjitha fazat e ciklit të jetës të PPP-ve.

Cikli jetësor të PPP-ve zakonisht përfshin tri faza kryesore:

1. FAZA E POLITIKAVE DHE PLANIFIKIMIT: Kjo fazë, përfshin themelimin e kornizës ligjore, rregullative, institucionale dhe politike për PPP-të. Organizatat buxhetore duhet të zhvillojnë politika dhe prioritetet të artikuluar në mënyrë të qartë para se të implementojnë projektet e PPP-ve. PPP-të duhet të konsiderohen brenda një kornize më të gjerë të qëllimeve dhe prioritetëve. Faza e politikave dhe planifikimit është kritike për përcaktimin e suksesit ose dështimit eventual të çfarëdo iniciative të PPP-ve.

2. FAZA E TRANSAKSIONIT: Qëllimi i fazës së transaksionit është që të sigurohet vlera më e mirë për paratë. Kjo arrihet përmes analizës kuantitative dhe kualitative të opsioneve të projektit (studimi i arsyeshmërisë) dhe themelimit të standardeve dhe shtytjeve të performancës. Është imperative që puna të strukturohet në atë mënyrë që të jenë e lehtë për punët bankare, e në të njëjtën kohë të arrihet ndarja optimale e rrezikut. Shtytjet konkurruese të përfshira në procesin e prokurimit gjithashtu ndihmojnë në arritjen e vlerës më të mirë për para. Faza e transaksionit përfundon kur marrëveshjet për projekt janë formalizuar dhe partneri privat ka arritur mbylljen financiare për projektin.

3. FAZA E PARTNERITETIT: Gjatë kësaj faze, partneri privat operon me hapësirën e infrastrukturës, përderisa organizata buxhetore ofron mbikëqyrje dhe monitorim të punës. Faza e partneritetit përfshin një numër të niveleve të ndryshme, përfshi (i) ndërtimin; (ii) operacionet dhe menaxhimit; dhe (iii) shkëputjen / dorëzimi i aseteve. Aktivitetet tjera gjatë kësaj faze mund të përfshijnë zgjedhjen e kontesteve, ri-negocimi, rregullimi, etj. Në të vërtetë, kjo marrëdhënie afatgjatë kërkon një strukturë efektive qeverisëse, si dhe nëpunës të trajnuar publik të cilët mund të veprojnë si palë kompetente e PPP-ve.

FAZA E POLITIKAVE
DHE PLANIFIKIMIT ■

FAZA E
TRANSAKSIONIT ■

FAZA E
PARTNERITETIT ■



RRETH NJËSISË TË CENTRALIZUAR TË PPP NË MEF – “PARTNERITETET KOSOVA”


DEKLARATA E MISIONIT

Për të promovuar dhe ndihmuar në implementimin e Partneriteteve-Publike-Private përgjatë shumë sektorëve në mënyrë që të arrihen forma efikase dhe efektive të ofrimit të shërbimeve publike.

QËLLIMET E PARTNERITETET KOSOVA

- Menaxhimi i programit të centralizuar të PPP përgjatë shumë sektorëve;
- Krijimi i kornizës së duhur mundësuese për PPP;
- Të veproj si lidhje efektive në mes të prioriteteve politike dhe strukturave institucionale;
- Themelimi, promovimi, dhe shpërndarja e standardeve dhe praktikave më të mira për identifikimin, zhvillimin, dhe implementimin e projektit;
- Themelimi dhe promovimi i proceseve të standardizuara të tenderëve për të krijuar përputhshmëri dhe parashikueshmëri;
- Ofroj informata për mundësi investimi për investitorët potencial;
- Promovoj edukimin, trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve;
- Koordinoj prezantimin, analizat dhe zgjedhjen e projekteve me ministritë, NP-të, komunat dhe organizatat tjera buxhetore;
- Të shërbej si pikë ndërlidhëse me atkerët tjerë;
- Të korrigjoj dhe të vlerësoj projektet PPP dhe të aprovoj të gjitha projektet që kërkojnë përkrahje nga qeveria (kontribute, garanci, subvencione, etj.).
- Të ofroj udhëzimet e nevojshme, ndihmën teknike dhe përkrahjen për ministritë, NP-të, komunat dhe organizatat tjera buxhetore;
- Të mbaj lidhje të afërt me njësitë e mbikëqyrjes dhe monitorimit brenda ministrive, NP-ve, komunave dhe organizatave tjera buxhetore përgjatë zgjatjes së projektit.

AKTIVITETET E PARTNERITETET KOSOVA:



Qëllimet e Partneritetet Kosova:

- Qeverisje e përmirësuar publike e infrastrukturës dhe shërbimeve
- Performancë e optimizuar financiare e aseteve infrastrukturore
- Vlera për para në ofrimin e shërbimeve
- Angazhim strategjik i partnerëve të sektorit privat

SI MUND TË NDIHMOJË PARTNERITETET KOSOVA ORGANIZATËN TUAJ:

Partneritetet Kosova ofron shërbime këshilluese që kanë të bëjnë me pothuajse të gjitha fazat e ciklit jetësor të partneriteteve-publike-private. Ne kemi një vështrim të integruar dhe të plotë të PPP dhe punojmë me institucionet për të siguruar iniciativat e suksesshme dhe të qëndrueshme të PPP-ve të cilat ofrojnë vlerën më të mirë për para.

Kjo në vijim është një listë përfaqësuese e disa prej shërbimeve të njësisë PPP:

Faza e politikave dhe planifikimit:

- Forcimi i kornizës ligjore dhe rregullative;
- Zhvillimi institucional dhe ndërtimi i kapaciteteve
- Krijimi i praktikave të standardizuara dhe veglat e punës
- Zhvillimi i procedurave dhe veglas për analizën e projekteve
- Zhvillimi i politikave
- Përgatitja e pilot projekteve / tubacionit të projektit
- Planifikimi strategjike për iniciativat PPP
- Marketing / marrëdhënie me publikun
- Menaxhimi i programit PPP

Faza e transaksionit:

- Vlerësimi i opsioneve financuese dhe të implementimit për kandidatët e projektit PPP
- Modelimi financiar për vlera-për-para, publike kundrejt private dhe vendimet e dizajnit të transaksionit
- Hulumtimi i ambientit ligjor dhe institucional
- Menaxhimi i transaksionit dhe i prokurimit të PPP
- Dizajni i mbikëqyrjes së projektit dhe strukturës qeverisëse.

Faza e partneritetit / implementimit:

- Ndihmë në transaksion
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i kontratës
- Zhvillimi i modeleve të kontratës qeverisëse
- Ndihmë në menaxhimin e kontratave
- Vlerësimi i projektit dhe programit të PPP
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi
- Përcaktimi i etapave i praktikave më të mira

Njësia PPP është e zotuar të punojë me institucionet publike dhe të vlerësojë me ndershmëri të gjitha opsionet financiare dhe implementuese.

INFORMATAT KONTAKTUESE

Ju lutemi drejtoni kërkesat dhe pyetjet te:

Partneritetet Kosova
Ministria e Ekonomisë dhe Financave
+381 (0)38 200 34 013

www.pppkosova.org

Publikuar me ndihmën e:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA